



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 200, datë 29.12.2020**

**PËR  
MIRATIMIN E KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES SË SHOQËRISË AUDITUESE,  
PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË AUTORITETIT TË  
MBIKËQYRJES FINANCIARE, PËR VITIN 2020**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 16, të Ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I :**

- 1. Miratimin e kriterëve të përzgjedhjes së shoqërisë audituese, për auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2020, të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, si më poshtë:**
  - a. Të jetë i licencuar apo i regjistruar në regjistrin publik si Auditues Ligjor për ushtrimin e kësaj veprimtarie në Republikën e Shqipërisë;**
  - b. Të paktën dy prej ortakëve ose të punësuarve të shoqërisë të kenë titull profesional “Auditues Ligjor”;**
  - c. Të ketë mbi 5 (pesë) vjet eksperiencë në fushën e auditimit ligjor të pasqyrave financiare të bankave ose subjekteve të tjerë financiare apo autoritete rregullatore financiare që aplikojnë kontabilitetin sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-ve);**
    - c/1. Shoqëria e auditimit duhet të ketë si pjesë të brendshme të strukturës së shoqërisë, burimet njerëzore me kompetencat e duhura profesionale për të kryer auditimin ligjor, ku ekipi i auditimit (pa përfshirë ortakun kryesor të**

auditimit) të ketë minimumi dy anëtarë me përvojë në kryerjen e angazhimeve të auditimeve ligjore;

- d. Të mos ketë konflikt interesash me subjektin që auditon, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”;
  - e. Të mos jetë subjekt i parashikimeve të nenit 55, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor”, sipas afateve të përcaktuara në vendimet përkatëse të Bordit të Mbikëqyrjes Publike;
  - f. Të paktën njëri nga ortakët të ketë fituar titullin ACCA/CFA.
2. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**ANËTAR**

**Deniz DERALLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Ervin METE**